

VENDIM
Nr. 528, datë 27.9.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 37, DATË 18.1.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 100/20 KV GJIRI I LALËZIT, DURRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 37, datë 18.1.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Tabela e përmendur në pikën 1 zëvendësohet me tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, me këtë përmbajtje:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë totale të shpronësimit prej 1 152 530.7 (një milion e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tridhjetë pikë shtatë) lekësh.

4. Vlera totale e shpronësimit, prej 1 152 530.7 (një milion e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tridhjetë pikë shtatë) lekësh, dhe vlera e shpenzimeve procedurale të përballohen nga fondet e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE, sh.a.), si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.”.

3. Pika 5 ndryshon, me këtë përmbajtje:

“5. Shpronësimi të fillojë brenda muajit tetor 2017.”.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a. dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

**Lista e pronarëve që shpronësohen për interes publik, për ndërtimin e nënstacionit 110/20 kV
Gjiri i Lalëzit, Durrës, Fshati Kuraten, Njësia Administrative Ishëm**

Nr.	Pronari	Z.K.	Nr. i pasurisë	Lloji	Sipërfaqja m ²	Çmim lekë/m ²	Vlera lekë	Shënime
1	Thoma Çuni	2332	242/2	Arë	2903.1	397	1 152 530.7	Konfirmim nga ZVRPP
2	Shtet	2332	242/1	Kullotë	231.6			Konfirmim nga ZVRPP